



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
KRYETARI

Nr. 989 prot.

Gramsh, më 28/02/2024

**VENDIM**

Nr. 09, datë 28.02.2024

**“PËR  
MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMEVE NË SHËRBIMIN CIVIL PËR  
VITIN 2024”**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; neni 8, pika 2, neni 9, gërma “b”, të nenit 18 të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr.108, datë 05.03.2014 “Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbimin civil, pika 2,3 dhe 11,13; Vendimit nr.08, datë 30.01.2024 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gramsh dhe njërive në varësi të saj, për vitin 2024” të kryetarit të bashkisë; me propozim të Sektorit të Burimeve Njerëzore,

**VENDOSA:**

1. Të miratojë Planin e Pranimit për vitin 2024 në shërbimin civil të administratës së Bashkisë Gramsh sipas Tabelës bashkëlidhur që është pjesë përbërëse e këtij vendimi, prej 48 (dyzetë e tetë) pozicionesh të shërbimit civil, nga të cilët:
  - a. 4 (katër) pozicione të kategorisë II, klasa II-b, niveli mesëm drejtues;
  - b. 9 (nëntë) pozicione të kategorisë III-a, klasa III-a/1, niveli i ulët drejtues;
  - c. 9 (nëntë) pozicione të kategorisë IV, klasa IV-a, niveli ekzekutiv;
2. Plani prej 22 (njëzetë e dy) pozicionesh të shpallet në Portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Web-n e Bashkisë dhe stendën e afishimeve publike të Bashkisë, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Pas shpalljes publike, nga Njësia Përgjegjëse për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, të nisnin procedurat për shpalljen e vendeve të lira dhe brenda 90 (nëntëdhjetë) ditësh procedurat e pranimit në shërbimin civil, nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele e ngritjes në detyrë për:
  - a. 4(katër) pozicione të nivelit të mesëm drejtues:
    - Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit;
    - Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;

-Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore;

b. 9 (nëntë) pozicione të nivelit të ulët drejtues:

-Përgjegjës i Sektorit të Turizmit, Rinisë dhe Integritimit në BE; Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile dhe Strehimit; Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Aseteve Vendore; -Përgjegjës i Sektorit të Protokollit dhe Arkivës; -Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit; -Përgjegjës i Sektorit të të Ardhurave nga Biznesi dhe Transporti; -Përgjegjës i Sektorit të të Ardhurave Familjare dhe Njësive Administrative; -Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit Financiar; -Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes Shoqërore;

• 9(nëntë) pozicione të nivelit ekzekutiv: -Specialist auditimi; -Specialist për mbrojtjen e fëmijëve (NJMF)/Punonjës Social; -Specialist për emergjencat civile dhe strehim; -Specialist për njësinë e monitorimit të performacës dhe Koordinator e të drejtës së informimit; -Inspektor tatim taksa terreni dhe transporti; -specialist për kontrollin e zhvillimit, investimet, burimeve natyrore, lejeve dhe licensave; -specialist hartim projektsh; -specialist për turizmin;- specialist i ndihmës ekonomike NJA Kushovë;

Për nivelin ekzekutiv, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të zhvillojë procedurat për pranimin në shërbimin civil nëpërmjet lëvizjes paralele dhe pranimit për herë të parë në shërbimin civil.

4. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Komisionet përkatëse për Lëvizjen Paralele, Ngritjen në Detyrë dhe Pranimin në Shërbimin Civil.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

P/Sektorin e Burimeve Njerëzore

Marije Kola

**KRYETARI**

**BESION AJAZI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 284/1 prot.

Gramsh, më 28/02/2024

**PLANI VJETOR I PRANIMEVE NË SHËRBIMIN CIVIL**

**BASHKIA GRAMSH 2024**

Në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr.108, datë 26.02.2014 ‘Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil’, pika 2,3 dhe pika 11,13, janë identifikuar 22 (njëzetë e dy) vende të lira, për vitin 2024, pozicione sipas kategorisë, klasave, niveleve e grupeve në tabelën vijuese,

Nr. kategoria	Emërtimi i kategorisë/klasës	Plani i pranimit viti 2023			
		Gjithsej	Pension	vend i ri	vakant
I-b	NC niveli i larte drejtues (klasa I)	1	-	-	-
II-b	NC niveli i mesem drejtues(klasa II)	5	-	-	4
III-a/1 III-b	NC niveli i ulet drejtues (klasa III)	17	-	-	9
III-b	NC kategoria ekzekutiv e (specialist) (klasa IV)	25	-	-	9
<b>TOTALI</b>		<b>48</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>22</b>

P/Sektorin e Burimeve Njerëzore

Marije Kola

**KRYETARI**

**Besion AJAZI**

